



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:168461

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597640

KPPP.nr.1560/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Družba za upravljanjeterjatev bank” D.D. në cilësinë e pasardhësit të “Factor Banka” D.D. me numër regjistrimi të biznesit 633962000, me seli në Davčna ulica 1, Ljubljajnë, Republika e Sllovenisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.Q., nga Shkupi, kundër debitorit “Dukagjini” SH.P.K. me numër regjistrimi të biznesit 70048929 dhe numër fiskal 600249420 me seli në rrugën “Ismail Qemajli” nr.2. Pejë, Republika e Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.Sh., avokate nga Prishtina dhe garantuesit R.Ll. me adresë në rrugën “Marija Shllaku” nr. 42, Pejë, Republika e Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.561/19 të datës 03.06.2019, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 19.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Dukagjini” SH.P.K dhe SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.561/19 i datës 03.06.2019, i nxjerr nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Družba za upravljanjeterjatev bank” D.D. në cilësinë e pasardhësit të “Factor Banka” D.D, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.561/19 të datës 03.06.2019, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Certifikatës së regjistrimit të pengut nr.R-11061700834 e datës 17.06.2011 dhe Konfirmimit të regjistrimit të pengut nr.R-20170207-153 të datës 07.02.2017, për pagesën e borxhit në shumë prej 1,411,365.06€ (një milion e katërqind e njëmbëdhjetë e treqind e

gjashtëdhjetë e pesë euro e gjashtë cent) me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 1,411,365.06€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 17.06.2018 deri në pagesën definitive të borxhit kryesorë dhe kamatës, në të kundërtën të ekzekutohet përbarimi përmes letrave me vlerë dhe pjesët në shoqëritë tregtare përmes sekuestrimit dhe shitjes së aksioneve të garantuesit të lëna peng dhe të letrave me vlerë në shoqëritë tregtare, si dhe kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në shoqërinë aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore të biznesit.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor P.nr.561/19 të datës 03.06.2019, për shkak të mungesës së bazës ligjore. Tutje, ka theksuar se certifikata e regjistrimit të pengut dhe konfirmimi i regjistrimit të pengut nuk përbëjnë titull ekzekutiv dhe se prapësimi i ushtruar nga debitori është i bazuar. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, të ndërpres procedurën përbarimore dhe ta obligoj kreditorin t'i paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore konform tarifës së Ministrisë së Drejtësisë.

Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe shtuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se certifikata e regjistrimit të pengut dhe konfirmimi i regjistrimit të pengut janë dokumente përbarimore, pasi që sipas kreditorit kontrata e pengut përmban të gjitha elementet e përcaktuara ligjore dhe se e njëjta është e vlefshme. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përbarimor.

Lidhur me këtë rast Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktvendimit Ep.nr.351/19 të datës 01.04.2021 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit lidhur me kamatën ligjore derisa kishte lejuar përbarimin për pjesën tjetër të detyrimit në lartësi prej 1,411,365.06€ (një milion e katërqind e njëmbëdhjetë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e gjashtë cent).

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së debitorit përmes Aktvendimit Ac.nr.6004/2021, kishte anuluar Aktvendimin Ep.nr.351/19 të datës 25.02.2022, duke aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit me kërkesën që gjykata e shkallës së parë të shqyrtoj nëse dokumenti përbarimor i plotëson kushtet për të qenë titull ekzekutiv.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe shqyrtimit, rekomandimeve të dhëna nga gjykata

e shkallës së dytë dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Në rastin konkret kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim me kërkesën për nxjerrjen e urdhrin përmbartimor në bazë të Certifikatës së regjistrimit të pengut nr.R-11061700834 e datës 17.06.2011 - Vërtetimi i deklaratës së njoftimit nr.R-11061700834 dhe akti i konfirmimit të regjistrimit të pengut nr.R-20170207-153 të datës 07.02.2017, si dhe Kontratës për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtarë të pengut – Kontrata për pengun e aksioneve Nr.7115/10 e datës 15.07.2010.

Gjykata shqyrtoi këtë çështje përmbartimore në përputhje me nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, dhe nenin 36 par.1 të LPP-së, ku përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Gjykata konform nenit 22 të LPP-së, i cili numëron në mënyrë taksative dokumentet e përmbartueshme dhe nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili përcakton se: *“2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.”*, gjeti se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbartimore, Certifikata e regjistrimit të pengut nr.R-11061700834 e datës 17.06.2011 - Vërtetimi i deklaratës së njoftimit nr.R-11061700834 dhe akti i konfirmimit të regjistrimit të pengut nr.R-20170207-153 të datës 07.02.2017, si dhe Kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtarë të pengut – Kontrata për pengun e aksioneve Nr.7115/10 e datës 15.07.2010, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përmbartueshme në përputhje me nenin 22 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës propozimi për përmbartim është paraqitur sipas Certifikatës së regjistrimit të pengut nr.R-11061700834 e datës 17.06.2011 e cila si dokument nuk është bashkangjitur fare në shkresat e lëndës, mirëpo kreditori ka bashkangjitur vërtetimin e deklaratës së njoftimit nr.R-11061700834 dhe aktin e konfirmimit të regjistrimit të pengut nr.R-20170207-

153 të datës 07.02.2017, të cilat janë paraqitur në kopje origjinale mirëpo të njëjtat nuk janë përcaktuar me nenin 22 të LPP-së si dokumente të përmbareshme.

Gjykata po ashtu vlerësoi se propozimi për përmbareshmësi është paraqitur sipas Kontratës për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtarë të pengut – Kontrata për pengun e aksioneve Nr.7115/10 e datës 15.07.2010, kjo kontratë është përcaktuar me nenin 22 LPP-së, si dhe nenin 5, par. 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareshmore, si dokument përmbaresh, mirëpo e njëjta në shkresat e lëndës është bashkëngjitur në kopje dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore në origjinal apo kopje të noterizuar.

Andaj sipas gjykatës, Vërtetimi i deklaratës së njoftimit nr.R-11061700834 dhe akti i konfirmimit të regjistrimit të pengut nr.R-20170207-153 të datës 07.02.2017, nuk paraqet dokument përmbaresh, si dhe Kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtarë të pengut – Kontrata për pengun e aksioneve Nr.7115/10 e datës 15.07.2010, nuk është dorëzuar në gjykatë në origjinal por kopje, andaj gjykata e pati të pamundur që të lë në fuqi Urdhrin Përmbaresh P.nr.561/19 të datës 03.06.2019, të nxjerr nga Përmbareshi Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Kontrata për pengun e aksioneve Nr.7115/10 e datës 15.07.2010, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbaresh është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbaresh është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbaresh duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaresh në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaresh origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par. 4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareshmërisë së nxjerrë nga përmbareshi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareshit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbareshi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbaresh nga përmbareshi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbareshit P.nr.561/19 të datës 03.06.2019, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase

propozimit për përmbardim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbardimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbardim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Andaj bazuar në të lartcekurat dhe nenin 71 dhe 73 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe neni 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1560/22, datë 19.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të Aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.